



## Shqyrtimi i Katërt i Tarifave të Energjisë Elektrike 2010 (SHTE4)

### Raporti Konsultativ

#### DEKLARATË

Ky Raport Konsultativ është përgatitur nga ZRrE me qëllim të pranimit të komenteve eventuale nga palët e interesit. Në dokument paraqiten qëndrimet dhe propozimet e ZRrE-së lidhur me aplikacionet e të licencuarve dhe nuk duhet të konsiderohen si vendime përfundimtare të ZRrE-së.

**Prishtinë, 26 shkurt 2010**

## 1 Hyrje

Zyra e Rregullatorit për Energji (ZrRE) është në procesin e shqyrtimit të aplikacioneve për Tarifa të Korporatës Energjetike të Kosovës sh.a. (KEK) dhe të Operatorit të Sistemit të Transmisionit dhe të Tregut të Kosovës sh.a. (KOSTT) që do të hyjnë në fuqi nga data 1 prill 2010.

Në këtë Raport Konsultativ paraqiten qëndrimet e ZrRE-së për kërkesat e KEK-ut dhe KOSTT-it për të hyrat e lejuara të cilat duhet të mblidhen nga tarifat e rregulluara.

Komentet eventuale nga palët e interesit duhet të adresohen në [ero.pricing-tariffs@ero-ks.org](mailto:ero.pricing-tariffs@ero-ks.org) me titullin “Komente për SHTE4”, apo të dërgohen në adresën e ZrRE-së të Departamentin për Tarifa dhe Çmime. Pritet që ZrRE do të marrë vendim përfundimtar deri më 15 mars 2010 pasi të ketë marrë në konsideratë komentet e pranuar nga palët e interesit.

## 2 Procesi i Shqyrtimit Tarifor

Shqyrtimi tarifor është një proces interaktiv në mes të ZrRE-së, të licencuarve (KEK-ut dhe KOSTT-it) dhe palëve të interesit. Fillimisht ZrRE-ja i ka dërguar parimet dhe orarin e shqyrtimit tarifor, sipas të cilave të licencuarit i dorëzojnë aplikacionet preliminare. Pas komenteve dhe vërejtjeve të ZrRE-së për aplikacionet preliminare, dorëzohen aplikacionet finale për të cilat përpilohet ky Raport Konsultativ, që paraqet qëndrimet dhe propozimet e ZrRE-së për të Hyrat e Lejuara dhe Tarifat për vitin që vjen. Pas marrjes së komenteve nga palët e interesit lidhur me këtë raport, ZrRE-ja do të marrë vendimin për tarifat e reja. Gjatë këtij procesi, janë shqyrtuar të gjitha kostot të cilat janë të nevojshme për funksionimin normal të të licencuarve, duke u bazuar në Rregullën e Çmimeve dhe Metodologjinë Tarifore të ZrRE-së.



Figura 1: Procesi i Shqyrtimit të Katërt të Tarifave të Energjisë Elektrike (SHTE4)

## 3 Mënyra e shqyrtimit të aplikacionit final

Vlerësimin e aplikacioneve për të Hyra e Lejuara dhe Tarifa e të licencuarve ZrRE-ja e ka ndarë në tri faza:

- I. ka vlerësuar kërkesën fillestare të të licencuarve, siç është dorëzuar në aplikacionin për tarifa;

- II. ka korrigjuar gabime në aplikacionet e të licencuarve dhe ka azhurnuar aplikacionet me të dhëna të reja;
- III. ka dhënë propozimet e saj për të Hyrat e Lejuara dhe Tarifat për vitin 2010 .

### 3.1 Vlerësimi i kërkesës

Gjatë fazës së parë të vlerësimit, ZRrE-ja ka analizuar vlerat e kërkuara nga KEK-u dhe KOSTT-i, duke u fokusuar kështu në vlerat e aplikacioneve siç janë dorëzuar nga të licencuarit. Pas analizimit të aplikacioneve, ZRRE ka konstatuar se të Hyrat e Kërkuara për vitin 2010 janë 177.6 milion euro, që krahasuar me të Hyrat e Lejuara të vitit të kaluar prej 139.8 milion euro, paraqet një rritje prej 28%.

Sipas Bilancit Energjetik të dorëzuar nga KEK-u, shitjet e energjisë të konsumatorët e rregulluar parashikohet të rriten për 9.2% krahasuar me shitjet e parashikuara gjatë përcaktimit të tarifave të vitit 2009, dhe për 7.0% krahasuar me shitjet e realizuara gjatë vitit 2009. Kërkesa e të licencuarve në aplikacione, pas bashkërenditjes së tyre është 177.6 milion euro që rezulton në nevojën për rritjen e tarifave të tanishme për 13.6% sipas strukturës së paraqitur në Tabelën 1.

Nëse ngarkesat e tanishme të transmisionit mbeten të pandryshuara, atëherë të hyrat e pritura për KOSTT-in do të ishin 20.7 milion euro që paraqet rritje prej 2.3 milion eurosh krahasuar me të hyrat e lejuara në vitin 2009 si rezultat i rritjes së pritur të kërkesës për energji. Kjo nënkupton që të hyrat e kërkuara nga KOSTT-i për vitin 2010 prej 19.1 milionë euro (duke përfshirë edhe koston e blerjes së humbjeve) paraqesin zbritje të ngarkesës mesatare të transmisionit për 7.6%.

APLIKACIONI I PRANUAR	Minierat	Gjenerimi	Distribucioni	Furnizimi	KEK	KOSTT	GJITHSEJTË	
Shpenzimet Operative (pa blerje të energjisë)	€000	42,244	30,802	18,714	17,279	109,039	7,978	117,017
Zhvlerësimi	€000	5,572	4,202	1,051	507	11,333	1,739	13,071
Kthimi i Lejuar	€000	18,838	8,787	4,238	308	32,171	1,588	33,759
Importi	€000				75,540	75,540		75,540
Blerjet e Energjisë jashtë KEK-ut	€000				2,818	2,818		2,818
Shërbimet Ndhimëse	€000				0	1,624		1,624
Kostot e AQ	€000	5,046	2,399	1,768	1,751	10,964		10,964
<b>GJITHSEJTË KOSTOT E LEJUARA</b>	€000	<b>71,700</b>	<b>46,190</b>	<b>25,771</b>	<b>98,203</b>	<b>241,864</b>	<b>12,929</b>	<b>254,793</b>
Shitjet ndaj Konsumatorëve të Privilegjuar	€000				-21,281	-21,281		-21,281
Eksporti	€000				-4,430	-4,430		-4,430
Të hyra tjera Operative	€000	-1,500				-1,500		-1,500
Subvencionet	€000				-50,000	-50,000		-50,000
Azhustimet	€000				0	0		0
<b>GJITHSEJTË TË HYRAT E LEJUARA</b>	€000	<b>70,200</b>	<b>46,190</b>	<b>25,771</b>	<b>22,492</b>	<b>164,653</b>	<b>12,929</b>	<b>177,582</b>
					2010 Tarifa Mesatare e Parashikuar	€c/kWh		5.58
					Tarifa Mesatare e Kërkuar	€c/kWh		6.34
					<b>KËRKESA PËR RITJEN E TARIFËS MESATARE</b>			<b>13.6%</b>

Tabela 1: Përmbledhje e të Hyrave të kërkuara sipas aplikacioneve të të licencuarve

### 3.2 Korrigjimet dhe Bashkërenditjet e ZRrE-së

Aplikacionet, ashtu siç janë pranuar, përmbajnë një numër gabimesh në llogaritje apo të dhëna hyrëse të pasakta. ZRRE-ja i ka korrigjuar ato si dhe ka bashkërenditur aplikacionet me të dhënat më të reja mbi shpenzimet kapitale aktuale për vitin 2009. Sipas Metodologjisë së Tarifave, ZRrE-ja ka bërë rregullimet për të kompensuar ndryshimet në mes të shpenzimeve kapitale të realizuara dhe atyre të lejuara si dhe të humbjeve në transmision në vitin 2009. Këto korrigjime dhe rregullime janë dhënë të përmbledhura në vijim.

Duhet të theksohet se aplikimi i këtyre korrigjimeve dhe rregullimeve nuk nënkupton pranimin nga ZRRE-ja, të shpenzimeve të propozuara e të përfshira në aplikacionet e të licencuarve. Shqyrtimi i arsyeshmërisë së këtyre shpenzimeve nga ZRRE-ja është dhënë po ashtu në vijim.

#### 3.2.1 Korrigjimet

Korrigjimet e ZRRE-së janë në:

- **korrigjimin e gabimeve** në llogaritje dhe të dhëna në aplikacionet e KEK-ut dhe KOSTT-it. Korrigjimet e bëra kanë rezultuar në rritjen e të hyrave të lejuara të KEK-ut për 291,000 euro ndërkaq të KOSTT-it për 66,000 euro;
- **reduktimin e shpenzimeve kapitale të supozuara nga KEK-u në vitin 2009 për të korresponduar me ato të realizuara.** Ky reduktim zvogëlon vlerën fillestare të bazës së asetëve në bazë të së cilës llogaritet zhvlerësimi dhe kthimi i lejuar që përfshihet në të hyrat e lejuara për 2.3 milionë euro;
- **llogaritjen e marginës së furnizimit dhe të hyrave të planifikuara nga shitjet të konsumatorët e privilegjuar** nga Furnizuesi publik, që ndryshojnë nga vlerat e paraqitura në aplikacionin për tarifa. Kjo ka ndikuar që të hyrat e lejuara të KEK-ut të zvogëlohen për 1.1 milionë euro në vitin 2010.
- **zbritjen e të ardhurave të fituara nga Divizioni i Gjenerimit të KEK-ut përmes kontratës për shërbime ndihmëse** me KOSTT-in. Kjo zvogëlon të hyrat e lejuara të KEK-ut për 1.6 milionë euro.
- **Harmonizimin e kostos dhe volumit të humbjeve të lejuara në transmision** të përfshira në të hyrat e lejuara të KOSTT-it për të korresponduar me koston dhe volumin e humbjeve të llogaritura nga aplikacioni i KEK-ut.

#### 3.2.2 Bashkërenditjet

ZRrE-ja bën bashkërenditjen e të hyrave të lejuara për të reflektuar ndryshimet në mes të kostove të lejuara dhe të realizuara në vitin paraprak, kurdo që këto ndryshime janë jashtë kontrollit të të licencuarve. Në llogaritjen e të hyrave të lejuara për të licencuarit në vitin 2010, ZRRE-ja ka bërë këto bashkërenditje:

- Sa herë që **shpenzimet kapitale të realizuara** kanë qenë më të mëdha ose më të vogla se sa është lejuar paraprakisht nga ZRRE-ja në përcaktimin e të hyrave të lejuara, atëherë ZRRE-ja

bashkërendit ndryshimin në lejjimet e zhvlerësimit dhe kthimit të lejuar në vitin<sup>1</sup> vijues. Kjo ofron stimulim për të licencuarit për të përmbushur ose kaluar caqet e shpenzimeve kapitale të përfshira në të hyrat e lejuara, duke pasur parasysh nevojën për investime në Kosovë. Gjatë vitit 2009, shpenzimet kapitale totale të KEK-ut kanë qenë më të ulëta se ato të përfshira në të hyrat e lejuara të vitit 2009, duke çuar kështu në një ulje kompensuese të të hyrave të lejuara për vitin 2010 në vlerë prej 2.2 milionë euro. Shpenzimet kapitale të KOSTT-it në vitin 2009 ishin më të larta se sa ato të lejuara, që rezultojnë në rritje të të hyrave të lejuara prej 455,000 euro në vitin 2010.

- **Humbjet aktuale të transmisionit** për të cilat KOSTT-i paguan Furnizuesin Publik KEK-un mund të ndryshojnë nga humbjet e lejuara për shkak të ndryshimeve në volumet totale të transmetuara, të cilat janë jashtë kontrollit të KOSTT-it, dhe për shkak të ndryshimeve në nivelin e humbjeve (e shprehur si faktor humbjeje ose përqindje) të cilën KOSTT mund ta kontrollojë në masë të madhe me investime në pajisjet transmetuese për të cilat iu kanë lejuar investimet. Gjatë vitit 2009, kostot aktuale të blerjes së humbjeve të transmisionit ishin 2.3 milionë euro nën ato që do të mund të ishin duke pasur parasysh normën e humbjes së lejuar dhe vëllimet aktuale të transmisionit në vitin 2009. ZRRE-ja vlerëson që KOSTT-i mund të konsiderohet si kontribuues vetëm për 50% të këtij kursimi dhe i lejohet ta mbajë atë shumë në vlerë prej 1.15 milion euro. Kostot e realizuara të KOSTT-it në vitin 2009 për blerjen e humbjeve në transmision kanë qenë rreth 1.1 milionë euro mbi nivelin e lejuar, që paraqet një pjesë të kursimeve totale që i lejohet KOSTT-it. Kjo rezulton në rritjen e të hyrave të lejuara të KOSTT-it për 0.05 milionë euro.
- Gjatë vitit 2009, ZRRE-ja ka pezulluar përkohësisht obligimin që Gjenerimi i KEK-ut t'i paguajë ZRRE-së **taksat e licencës**. Niveli i taksave të licencës është jashtë kontrollit të të licencuarit dhe përcillet te tarifat. ZRRE-ja ka rregulluar të hyrat e lejuara të Gjenerimit të KEK-ut në vitin 2010 nga lart poshtë përmes ndryshimit në mes të taksave të lejuara të licencave në vitin 2010 dhe atyre të paguara aktualisht. Kjo zvogëlon të hyrat e lejuara të Gjenerimit të KEK-ut për 976,000 euro.

### 3.2.3 Përmbledhje e korigjimeve dhe rregullimeve të ZRRE-së

Për arsyet e përmendura më lart, vlera e kërkuar për të Hyrat e Lejuara dhe Tarifat për vitin 2010 zvogëlohet për 7.3 milionë euro; nga 177.5 milionë euro në 170.1 milionë euro. Kjo paraqet rritje të tarifës mesatare prej 8.8%. Një përmbledhje e të hyrave të lejuara dhe të kostove, pas rregullimeve dhe korigjimeve të ZRRE-së, jepet në Tabelën 2:

---

<sup>1</sup>Për shembull, në qoftë se shpenzimet kapitale të realizuara do të ishin 1 milion euro më pak se ato të përfshira në të hyrat e lejuara atëherë i licencuari do të kishte fituar 20,000 euro në lejjimet e zhvlerësimit dhe 65,500 euro në kthimin e lejuar për investime që në fakt nuk i ka realizuar (në këtë llogaritje është supozuar jetëgjatësia e asetëve prej 25-vjetësh dhe MPKK-ja prej 13,1% për asetet e shtuara në mes të vitit). Rregullimi nga ZRRE-ja zvogëlon të hyrat e lejuara në vitin pasues për 85,500 euro në lejjime të mbivlerësuar të zhvlerësimit dhe kthimit të lejuar, të përshtatura për të ardhurat nga kamata në këto të hyra gjatë vitit paraprak.

		Minierat	Gjenerimi	Distribucioni	Furnizimi	KEK	KOSTT	GJITHSEJTË
Shpenzimet Operative (pa blerje të energjisë)	€000	42,244	30,802	18,714	18,249	110,009	7,978	117,987
Zhvlërimi	€000	5,122	4,360	1,071	527	11,081	1,806	12,887
Kthimi i Lejuar	€000	17,115	8,925	4,293	264	30,596	1,587	32,183
Importi	€000				75,540	75,540		75,540
Blerjet e Energjisë jashtë KEK-ut	€000				2,581	2,581		2,581
Shërbimet Ndhimëse	€000					0	1,624	1,624
Kostot e AQ	€000	5,066	2,409	1,775	1,758	11,008		11,008
<b>GJITHSEJTË KOSTOT E LEJUARA</b>	<b>€000</b>	<b>69,547</b>	<b>46,496</b>	<b>25,853</b>	<b>98,918</b>	<b>240,814</b>	<b>12,995</b>	<b>253,809</b>
Shitjet ndaj Konsumatorëve të Privilegjuar	€000				-23,388	-23,388		-23,388
Eksperti	€000				-4,430	-4,430		-4,430
Të hyra tjera Operative	€000	-1,500	-1,624			-3,124		-3,124
Subvencionet	€000				-50,000	-50,000		-50,000
Azhustimet	€000	-1,224	-1,049	-893	-22	-3,187	504	-2,683
<b>GJITHSEJTË TË HYRAT E LEJUARA</b>	<b>€000</b>	<b>66,823</b>	<b>43,823</b>	<b>24,960</b>	<b>21,079</b>	<b>156,685</b>	<b>13,500</b>	<b>170,185</b>
						2010 Tarifa Mesatare e Parashikuar	€/kWh	5.58
						Tarifa Mesatare e Kërkuar	€/kWh	6.08
						<b>KËRKESA PËR RRIJTJEN E TARIFËS MESATARE</b>		<b>8.8%</b>

Tabela 2: Përmbledhja e të Hyrave të Lejuara pas rregullimeve të ZRrE-së

### 3.3 Propozimet e ZRrE-së

Pas shqyrtimit të detajuar të secilës kategori të kostove, ZRrE-ja ka konstatuar se disa nga kostot e kërkuara nuk janë të arsyeshme apo paraqesin ndryshim jo proporcional me nivelin e lejuar dhe të realizuar të kostove të të njëjtës kategori në vitin paraprak. Ndërhyrjet e ZRrE-së dhe propozimet e saj për kostot e lejuara për vitin 2010 janë të dhëna në Vijim.

#### 3.3.1 Korrigjimi i Bazës së Rregulluar të Aseteve (RAB) dhe Bazës së Rregulluar të Aseteve të financuara komercialisht (RABf) të KEK-ut dhe të KOSTT-it

Bazuar në parimet e caktuara paraprakisht, është vendosur që:

- Vlera e asetëve që përfshihet në **Bazën e Rregulluar të Aseteve (RAB)** për të licencuarit të jetë zero në 1 janar të vitit 2006, siç është përcaktuar në Metodologjinë Tarifore, dhe të rritet krahas investimeve të realizuara kapitale të cilat bashkërenditen në vitet në vijim. RAB-i përdoret për të llogaritur zhvlërimin e lejuar që përfshihet në të hyrat e lejuara të të licencuarve.
- Të licencuarit përfitojnë një kthim të lejuar në kostot e lejuara kapitale për asetet të cilat janë ndërtuar duke përdorur financim nga pasuria apo nga borxhi. Kthimi i lejuar nuk lejohet në asete të cilat janë ndërtuar duke përdorur financime nga grantet për arsye se të licencuarit nuk ballafaqohen me kosto financimi për këto asete. Për këtë arsye është formuar **baza e rregulluar e asetëve që nuk përfshinë asetet e financuara nga grantet (RABf)** me të cilën llogaritet kthimi i lejuar.

Në aplikacionin e KEK-ut, RAB-i dhe RABf-i kanë qenë të deklaruar të barabarta, pavarësisht faktit se një pjesë e madhe e aseteve të KEK-ut kanë qenë të financuara nga grantet. Kjo nuk është në pajtim me parimin e dytë të përmendur më lartë. Për këtë arsye, ZRrE-ja ka llogaritur vlerën e RAB-it dhe të RABf-it për 1 janar 2010 të KEK-ut duke zbatuar parimet e lartpërmendura dhe duke përdorur informatat e pasqyrave financiare të audituara të KEK-ut për shtesat dhe shlyerjet e aseteve në secilin vit. Kjo llogaritje është shqyrtuar me KEK-un dhe ata janë pajtuar me llogaritjet e ZRrE-së.

ZRrE-ja ka llogaritur të njëjtën gjë edhe për KOSTT-in edhe pse KOSTT-i ka ndarë RAB-in dhe RABf-in në aplikacionin e tyre. ZRrE-ja nuk ka pasur mundësi të diskutojë këtë llogaritje me KOSTT-in por do ta diskutojë më tutje para lëshimit të vendimit përfundimtar.

Me këtë korrigjim është konstatuar se RAB-i që është përdorur deri më tani ka qenë i nënvlerësuar përderisa RABf-i ka qenë i mbivlerësuar. Nga kjo konkludohet se vlera e zhvlerësimit që bën pjesë në të Hyrat e Lejuara të KEK-ut dhe të KOSTT-it në përgjithësi duhet të rritet, përderisa vlera e Kthimit të Lejuar që kalkulohet nga RABf duhet të zvogëlohet. Ndryshimet në mes të RAB-it dhe RABf-it të llogaritur nga ZRrE-ja dhe atyre të llogaritur në aplikacion janë shumë më të vogla për KOSTT-in krahasuar me KEK-un, që ka ndikuar që edhe ndikimi në të hyrat e lejuara të jetë shumë më i vogël për KOSTT-in krahasuar me KEK-un.

Efekti neto i këtij korrigjimi ka qenë që të hyrat e lejuara të vitit 2010 të zvogëlohen për 4.6 milion euro për KEK-un dhe për 0.05 milion euro për KOSTT-in. Megjithatë, ZRrE-ja ende nuk e ka bërë këtë korrigjim në të hyrat e lejuara të KOSTT-it pasi që ende nuk i ka bashkërenditur këto llogaritje me KOSTT-in.

### **3.3.2 Humbjet në Distribucion**

Kërkesa e KEK-ut për humbjet e lejuara teknike për vitin 2010 është 17.5% e energjisë që hyn në distribucion apo 758.3 GWh. ZRrE konstaton se kjo vlerë është më pak se vlera e humbjeve teknike të realizuara në vitin 2009 (18.05%) por është më e lartë krahasuar me vlerën prej 17.1%.të lejuar paraprakisht nga ZRrE-ja. KEK-u ka pasur investime të konsiderueshme kapitale në rrjetin e distribucionit dhe ZRrE-ja beson se këto duhet të reflektohen me zbritjen e humbjeve. Duke pasur parasysh këtë, ZRrE-ja propozon që edhe në vitin 2010 niveli i humbjeve të lejuara teknike të jetë 17.1% që paraqet zbritje prej 27 GWh. ZRrE-ja parasheh që kjo do të ndikojë në zvogëlimin e shkëmbimit të importit dhe për këtë arsye nuk do të ketë ndikim në koston e blerjes së energjisë.

### **3.3.3 Kostoja e Importit**

Në aplikacionin për tarifa KEK-u ka kërkuar shumën prej 61.1 milion euro për blerjen e energjisë nga importi. Vëllimi i energjisë i supozuar për kalkulimin e kësaj vlere është 859.9 GWh që paraqet çmim mesatar prej 71.1 €/MWh.

KEK-u ka llogaritur këtë çmim duke përdorur çmimet aktuale për kuartalin e parë të vitit 2010 dhe duke parashikuar çmimet e blerjes së energjisë nga importi në 3 kuartalet vijues. ZRrE ka konstatuar se çmimet e parashikuara nga KEK-u janë më të mëdha sesa çmimet aktuale dhe të pritura. Për këtë arsye, ZRrE-ja ka bërë parashikimet e saj për çmimin e energjisë nga muaji Prill 2010 deri në fund të

vitit, duke përdorur vlerat aktuale të kontratave të kuartalit të parë dhe duke supozuar se këto lëvizin ngjashëm me lëvizjen e çmimeve të *European Energy Exchange*<sup>2</sup>. ZRrE-ja ka ngritur këtë mesatare të importit për të lejuar hapësirë për rritje të paparashikuara të çmimit të importit gjatë këtij viti duke pasur parasysh se gjatë viteve të kaluara çmimet e importit kanë pësuar ndryshime të mëdha. Kështu ZRrE-ja ka llogaritur që çmimi mesatar i blerjes së energjisë nga importi në vitin 2010 të lejohet në nivelin 69.5 €/MWh.

Çmimi i propozuar i ZRrE-së për importin e energjisë zvogëlon kërkesën për të Hyrat e Lejuara të KEK-ut për 1.1 milion euro.

Në aplikacion KEK-u po ashtu ka kërkuar lejimin prej 14.4 milion euro për blerje të energjisë emergjente nga importi, për mbulimin e kërkesës në rastet kur Kosova A apo Kosova B papritmas dalin nga operimi. KEK-u zotohet se ky lejim do t'i ndihmojë që të ofrojë furnizim 24:0 në të gjitha daljet e klasifikuara A dhe B.

Importet emergjente zbatohen në formë të dy llojeve të kontratave – një për 72 orë furnizim që është i gatshëm një herë në muaj dhe një për 6 orë furnizim që është i gatshëm deri në tetë herë në muaj. Bazuar në përvojat e viteve të kaluara, ZRrE-ja beson se çmimet e supozuara nga KEK-u për blerjen e energjisë për kontrata 72 orëshe janë mbivlerësuar dhe thekson se ky çmim është afër çmimit normal të kontratës së blerjes së energjisë. ZRrE-ja poashtu konstaton se përdorimi i realizuar i kontratave emergjente 6-orëshe është më i rrallë krahasuar me supozimin e KEK-ut dhe ka zvogëluar lejimin për këto lloje të kontratave. Propozimet e ZRrE-së për importin në raste emergjente zvogëlojnë kërkesën e KEK-ut për 4.2 milion euro në gjithsejtë 10.2 milion euro të lejuara.

ZRrE thekson se lejimi i importit të energjisë emergjente ka kuptim vetëm kur furnizohen në mënyrë të barabartë kategoritë A, B dhe C. Supozimi i KEK-ut për mos-përfshirjen e kategorisë C në furnizim nga importi emergjent është diskriminues për këtë kategori, ngase mund të ndikojë në keqësimin shtesë të furnizimit të kësaj kategorie me qëllim të përmbushjes së kriterit për kategorinë A dhe B. Prandaj, ZRrE-ja lejon këtë shumë të të hyrave me qëllim të blerjes së energjisë emergjente për furnizimin e të tri kategorive në mënyrë jo diskriminuese.

### **3.3.4 Mesatarja e Ponderuar e Kostos së Kapitalit (MPKK)**

ZRrE-ja ka llogaritur edhe një herë Mesataren e Ponderuar të Kostos së Kapitalit për të reflektuar zvogëlimin e tatimit në fitim në Kosovë nga 20% në 10%. Nga kjo llogaritje është përcaktuar që MPKK-ja për këtë shqyrtim tarifor të zvogëlohet nga 13.8% sa është aktualisht në 13.1%. Kjo ndikon në zvogëlimin e të hyrave të lejuara prej 1.2 milion euro për KEK-un dhe për rreth 0.06 milion euro për KOSTT-in.

---

<sup>2</sup> Kjo llogaritje përdorë lëvizjet në çmimet tremujore të energjisë bazë dhe pik duke përdorur Phelix futures. Këto parashihen të kenë zbritje nga nivelet e tanishme gjatë muajve të verës së vitit 2010 dhe pastaj të pësojnë ngritje përsëri prej 7-15% krahasuar me nivelin e tanishëm në kuartalin e fundit të vitit 2010.

### **3.3.5 Jetëgjatësia e aseteve të Divizionit të Minierave**

KEK-u ka kërkuar që jetëgjatësia e aseteve të minierave të reduktohet nga niveli aktual prej 35 vjetësh në 25 vjet. KEK-u e arsyeton kërkesën e vet me faktin se investimet e tanishme në miniera janë shumë të ndërlidhura me zgjatjen e jetëgjatësisë së minierave ekzistuese dhe nuk do të kenë vlerë pasi që këto miniera të mbyllen, që pritet të jetë në një kohë shumë më të shkurtër sesa 35 vite.

ZRrE-ja e pranon propozimin e KEK-ut për shkurtimin e jetëgjatësisë së këtyre aseteve. Ky ndryshim rrit të hyrat e lejuara të KEK-ut për vitin 2010 me vlerën prej 1.69 milion euro.

### **3.3.6 Borxhet e këqija**

Në aplikacionin për tarifa, KEK-u ka kërkuar që t'i lejohen 3.2 milion euro për borxhe të cilat KEK-u nuk ka qenë në gjendje të inkasojë.

ZRrE vazhdon të qëndrojë pranë propozimit të saj të mëhershëm që borxhet e këqija të mos përfshihen në të hyrat e lejuara të KEK-ut, ngase kjo do të nënkuptonte mbulim të borxheve të konsumatorëve që nuk paguajnë nga konsumatorët që paguajnë.

Qëndrimi i ZRrE-së mbi mos-pranimin e përfshirjes së borxheve të këqija zvogëlon nivelin e të hyrave të kërkuara nga KEK-u për 3.2 milion euro.

### **3.3.7 Kapitalizimi i Shpenzimeve të Mirëmbajtjes nga KOSTT-i**

Gjatë vitit 2010 KOSTT ka realizuar vetëm 0.9 milion euro nga 3.9 milion euro të lejuara për shpenzime të mirëmbajtjes. Gjatë konsultimeve me ZRrE-në KOSTT-i ka sqaruar se është e obliguar të kapitalizojë një vlerë e shpenzimeve të mirëmbajtjes nga Standardet Kosovare të Kontabilitetit.

ZRrE konstaton se kapitalizimi i kësaj natyre shkakton përfshirje të dyfishtë të shpenzimeve të së njëjtës kategori. Së pari, këto kategori përfshihen në të hyra të lejuara si shpenzime operative, dhe pasi të kapitalizohen, përfshihen edhe një herë tjetër në formë të zhvlerësimit dhe të kthimit të lejuar për asetet që tashmë janë krijuar.

Për të shmangur llogaritjen e dyfishtë, ZRrE-ja propozon që shpenzimet kapitale të mirëmbajtjes të hiqen nga RAB dhe nga RABf duke zbritur kështu vlerën e kthimit të lejuar dhe zhvlerësimit që do të fitohej sikur kjo vlerë të kapitalizohet. Gjatë këtij kalkulimi, ZRrE-ja ka supozuar që vlera e kapitalizuar është ndryshimi në mes të shumës së lejuar dhe të realizuar për shpenzime kapitale gjatë vitit 2009.

Ky ndryshim zvogëlon të Hyrat e Lejuara të KOSTT-it për vitin 2010 me vlerë prej 761,000 euro.

### **3.3.8 Shpenzimet shtesë për mbulim të performansës**

Në aplikacionin për tarifa, KOSTT-i ka kërkuar shumën prej 0.1 milion euro për paga të bazuara në performansë për vitin 2010. ZRrE-ja nuk e sheh të arsyeshme që kosto të tilla të mbulohen nga tarifat e konsumatorëve të rregulluar. Për këtë arsye, ZRrE-ja propozon që të hyrat e lejuara të KOSTT-it të zvogëlohen për vlerën e kërkuar për këtë qëllim, e që rezulton në zvogëlim të të hyrave të lejuara të KOSTT-it për 0.1 milion euro.

#### 4 Subvencionet

Në aplikacionet e veta, KEK-u ka paraqitur vlerën e subvencioneve prej 50 milion eurosh të financuara nga Buxheti i Kosovës. Sipas Metodologjisë Tarifore, çdo subvencion duhet të zbritet nga të hyrat e lejuara që mbulohen nga tarifat e konsumatorëve të rregulluar. Sikur të mos lejoheshin këto subvencioneve, tarifa mesatare e nevojshme për të mbuluar të hyrat e lejuara do të duhej të rritej për 29% krahasuar me tarifat e tanishme.

#### 5 Përmbledhje e propozimeve të ZRrE-së

Pas propozimeve të lartshënuara, të hyrat e lejuara të nevojshme për funksionimin normal të Korporatës Energjetike të Kosovës dhe të Operatorit të Sistemit Transmisionit dhe të Tregut të Kosovës janë gjithsejtë 156.2 milion euro, ku janë të përfshira edhe 18.1 milion euro të lejuara për KOSTT-in. Ky nivel i të hyrave mund të mbulohet me një tarifë mesatare prej 5.58 cent/kWh që është përafërsisht e barabartë me mesataren e tarifave ekzistuese. Prandaj, ZRrE-ja propozon që tarifat e tanishme për konsumatorët fundorë të mos ndryshohen dhe si të tilla të aplikohen edhe për këtë periudhë të shqyrtimit tarifor. Struktura e të Hyrave të Lejuara sipas propozimit të ZRrE-së është dhënë në Tabelën 3.

		Minierat	Gjenerimi	Distribucioni	Furnizimi	KEK	KOSTT	GJITHSEJTË
Shpenzimet Operative (pa blerje të energjisë	€000	42,244	30,802	18,714	14,841	106,601	7,847	114,448
Zhvlërimi	€000	6,877	3,812	1,067	348	12,104	1,857	13,961
Kthimi I Lejuar	€000	16,292	4,696	3,078	76	24,143	934	25,077
Importi	€000				69,990	69,990		69,990
Blerjet e Energjisë jashtë KEK-ut	€000				2,581	2,581		2,581
Shërbimet Ndhimëse	€000					0	1,624	1,624
Kostot e AQ	€000	5,138	2,443	1,801	1,783	11,164		11,164
<b>GJITHSEJTË KOSTOT E LEJUARA</b>	€000	<b>70,551</b>	<b>41,753</b>	<b>24,660</b>	<b>89,619</b>	<b>226,584</b>	<b>12,262</b>	<b>238,846</b>
Shitjet ndaj Konsumatorëve të Privilegjuar	€000				-22,112	-22,112		-22,112
Eksporti	€000				-4,430	-4,430		-4,430
Të hyra tjera Operative	€000	-1,500	-1,624			-3,124		-3,124
Subvencionet	€000				-50,000	-50,000		-50,000
Azhustimet	€000	-1,224	-1,049	-893	-22	-3,187	235	-2,952
<b>GJITHSEJTË TË HYRAT E LEJUARA</b>	€000	<b>67,827</b>	<b>39,080</b>	<b>23,768</b>	<b>13,056</b>	<b>143,731</b>	<b>12,497</b>	<b>156,229</b>
						2010 Tarifa Mesatare e Parashikuar	€/kWh	5.58
						Tarifa Mesatare e Kërkuar	€/kWh	5.58
						<b>KËRKESA PËR RRITJEN E TARIFËS MESATARE</b>		<b>-0.1%</b>

Tabela 3: Përmbledhje e të Hyrave të Lejuara sipas propozimeve të ZRrE-së